

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE

Nr. 984 Rep.  
Nr. 546 Kol.

MARREVESHJE SIGURUESE  
MBI KUOTAT E PJESEMARRJES NE SHOQERI



Ne Tirane, sot me date 09 / 03 / 2018 (dymije e tetembedhjete), para meje Noteres M. Sadushaj anetar Dhomes se Noterise Tirane me zyre ne V000 Parku B, u paraqiten personalisht palet:

**BARREMARRES / KREDIDHENES:**

Raiffeisen Bank Sh.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NUIS.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor ligjor Z. Erion BALLI identifikuar me Leternjoftim ID nr.025331288 dhe numer personal I00913039J dhe Znj. Gledisa BUXHUKU identifikuar me pasaporten me nr. BE7320171 (ketu e me poshte do te quhet Banka ose Barremarresi),

Dhe

**BARREDHENES:**

Erion Kola, i biri i Sadikut, dtl. 13.09.1978, lindur ne Markat, Sarande, dhe banues ne adresen Kodra e Diellit , Rruga e trendafilave, Ap 7/3, Tirane, identifikuar me nr.pasaporte BC1043012 dhe numer personal H80913080C (ketu e me poshte do te quhet Barredhes),

Donalda Kola, e bija e Hajros, dtl. 09.01.1982, lindur ne Sarande, dhe banues ne adresen Kodra e Diellit , Rruga e trendafilave, Ap 7/3, Tirane, identifikuar me nr.pasaporte BR4059909 dhe numer personal I25109077M (ne cilesine e bashkeshortes se barredhenesit e cila jep pelqimin per nenshkrimin e kesaj kontrate)

dhe

**KREDIMARRRES:**

Shoqëria "ESKO" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane/Qendren Kombetare te Biznesit, me vendimin/NUIS nr. K54509804C, datë 03/10/2005, me seli ne SARANDE Lagjia nr.1, Rruga Tolo Jovani, Godina nr.28, kati i pare e perfaqësuar nga administratori Erion Kola identifikuar me nr.pasaporte BC1043012 dhe numer personal H80913080C (ketuj e tutje Kredimarresi)

Baza Ligjore

Kjo kontrate bartohet bazuar ne nenet 6, 24, 31, 420, 605, e ne vazhdim te Kodit Civil,

- Ligjit nr.7829, dt.01.06.1994 "Per Noterine"

- Ligjit nr.8537, date 18.10.1999 "Per barret siguruese" ( i ndryshuar).

Neni 1

**INTERPRETIMI**

**1.1 PERKUFIZIME**

Ne kete Marreveshje, termat dhe shprehjet qe vijojne do te kene kuptimet e meposhtme:

(a) "Kolateral" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 2.1 te kesaj marreveshjeje.

(b) "Detyrime" do te thote te gjitha detyrimet, pergjegjesite dhe borxhet e cfaredo natyre apo lloji te Barredhenesit ndaj Barremarresit (duke perfshire ketu interesin, tarifat ligjore dhe shpenzimet) qe ai i detyrohet kohe pas kohe, te tashme apo te ardhme, te sigurta apo te mundshme, te maturuara apo jo, te zgjeruara apo te rinovuara qofshin, te marra persiper ne cdo kohe dhe nga kushdo, dhe cdo balance perfundimtare te papaguar deri tani.

(c) "Borxhe te tjera" do te thote libra, dokumente,shkresa,letra,shenime dhe te dhena elektronike, si dhe te gjitha llogarite e tashme dhe te ardhme, borxhet, pretendimet, detyrimet ne para dhe kerkesat e cdo natyre dhe lloji pavaresisht nese jane te evidentuara nga instrumentet, te cilat jane kerkuar ose do te kerkohen, do te paguhen, detyrime keto te Barredhenesit dhe te gjitha te ardhurat prej tyre.

(d) " Kuota" ka kuptimin e kuotave te pjesemarrjes ne shoqeri dhe te drejtat e lidhura me to sipas legjislacionit ne fuqi

(e) "Detyrime te siguruara" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 3.1 si vijon

(f) Te Drejtat e Lidhura "do te thote:

- (i) çdo dividend ose interes i paguar ose i pagueshem ne lidhje me Kuotat;
- (ii) çdo kuote, letra me vlere, te drejta, te holla ose pasuri te lindura ose te ofruara ne çdo kohe (nese me ane te kthimit, bonus, preferimit, te drejtave me kusht, zevendesimin, kembimin ose ndryshe) ne lidhje me ose mbi cilendo nga Kuotat;
- (iii) te gjitha dividente, interesat ose te ardhura te tjera ne lidhje me çdo aset te pemendur ne paragrafin (ii) me lart; dhe
- (iv) te gjitha te drejtat e votes ne lidhje me Kuotat, te cilat mund te ushtohen si ne asamblene e zakonshme, ashtu edhe ne asamblene e jashtezakonshme te Shoqerise.

## Neni 2

### BARRA SIGURUESE

#### 2.1 KRIJIMI I BARRES SIGURUESE

Barredhesis ketu Z. Erion Kola, eshte ortak i vetem i shoqerise **Shoqeria "ESKO"** shpk e organizuar sipas ligjeve te Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane/Qendren Kombetare te Biznesit, me vendimin/NUIS nr. K54509804C, datë 03/10/2005, me seli ne SARANDE Lagjja nr.1, Rruga Tolo Jovani, Godina nr.28, kati i pare.

Barredhesis ketu Z. Erion Kola, eshte nje nga ortaket e shoqerise "e-pumps" shpk e organizuar sipas ligjeve te Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tirane/ne Qendren Kombetare te Biznesit, me vendim/Nuis nr. L71420020I, datë 20/02/2017, me seli ne Tirane Vore Rruga Industriale Tirane-Vore, Km 11, 1032

Sipas Ekstrakteve te Regjistrimit Tregtar per te dhenat e Subjekteve per te dy Shoqerite me Pergjegjesi te Kufizuar struktura e ortakeve te shoqerive paraqet si ortak te saj barredhesisin si me poshte vijon:

- Erion Kola - 100% te kuotave te shoqerise **Shoqeria "ESKO"** shpk
- Erion Kola - 80% te kuotave te shoqerise **Shoqeria "e-pumps"** shpk

Me ane te kesaj marreveshje siguruese Barredhesis ketu i japin Barremarresit nje Barre Siguruese mbi kuotat ne total 100% te kuotave qe Z. Erion Kola zoteron tek **Shoqeria "ESKO"** shpk dhe Barre Siguruese mbi kuotat ne masen 80% te kuotave qe Z. Erion Kola zoteron tek **Shoqeria "e-pumps"** shpk me te cilat sigurojne pagesen, permbushjen dhe shlyerjen e te gjitha detyrimeve te siguruara te **Shoqerise "ESKO"** shpk, ndaj Barremarresit.

## Neni 3

### DETYRIMET E SIGURUARA

#### 3.1 DETYRIMET E SIGURUARA

Barra Siguruese qe jepet siguron pagimin dhe permbushjen e te gjitha detyrimet monetare (dhe detyrimet te cilat mund te vlersohen ne te holla) dhe detyrimet e Kredimarrjes kundrejt Kredidhesisit sve sipas Kontratave te Kredise me poshte, duke perfshire, por pa rene ne kundershtrim me parashikimet e pergjithshme parardhese, permbushjen e duhur te te gjitha detyrimeve per pagesat ne lidhje me kryegjene, interesat, kamat-vonesat, tarifat, kostot dhe shpenzimet, demet, taksa dhe taksat e pulles te pagueshme, çdo shume per sherbime ndermjetesimi qe do te pagohen pas parapagimit ose ripagimit te te gjitha apo nje pjese te Kredise ne nje date tjeter nga data e caktuar per pagesen, dhe te gjitha e çdonjera prej kostove, shpenzimeve, takse pulle, taksat apo tarifat e pagueshme ne lidhje me mbrojtjen, ruajtjen apo ekzekutimin e detyrueshem te te drejtave te Kredidheneve sipas Kontrate Kredie Bankare nr. \_\_\_ rep, nr. \_\_\_ kol, date \_\_\_ . \_\_\_ 2018 Kontrate per leshimin e instrumentave financiare dhe/ose kredie me kufi nr.783 rep nr.355 kol dt 21.11.2017 e ndryshuar me Kontrate per leshimin e instrumentave financiare dhe/ose kredie me kufi nr. \_\_\_ rep, nr. \_\_\_ kol, date \_\_\_ . \_\_\_ 2018 dhe te gjitha detyrimet e Shoqerise dhe te Barredhesisit sipas kesaj Marreveshjeje te lidhur ndermjet Kredidhesisit dhe Kredimarrjesit.

#### 3.2 INTERESI I VAZHDUESHEM

Kjo Kontratë do të jetë gjithashtu e detyrueshme për barredhesisit edhe pas ndonjë ndryshimi, transferimi ose rinovimi të Kontratës së Kredisë ose të kësaj Kontrate. Barredhesisit në mënyrë të shprehur bie dakort për vazhdimësinë e kësaj Kontrate në rast të rinovimit të të gjithë ose të një pjese të Detyrimeve të Siguruara (duke përfshirë një rinovim të Kontratës së Kredisë)

#### 3.3 APLIKIMI I PAGESAVE

Te gjitha parate e mbledhura apo te marra nga Barremarresi prej Barredhesisit do te shkojne per llogari te permbushjes se Detyrimeve ne menyren qe vete Barremarresi ka vendosur.

## Neni 4

### MARREVESHJET E BARREDHENESIT

#### 4.1 MARREVESHJE TE PERGJITHSHME

Barredhenesi bie dakord qe:

(a) do te njoftoje Barremarresin menjehere per:

- cdo ndryshim te emrit te Barredhenesit;

- cdo ndryshim te vendit ku Barredhenesi zhvillon aktivitetin e tij tregtar ose, nese Barredhenesi ka me shume se nje vend te tille, te selise kryesore te Barredhenesit;

- cdo rast mospermbushjeje (siç është përshkruar me poshte ne nenin 6);

(b) do te autorizojë barremarresin te beje, ekzekutoje, njohe dhe shpendaje formularet e njoftimit te regjistrimit dhe kalime te metejsme te te dhe transfertave, dokumenteve, rakteve, ceshetjeve dhe gjerave, duke perfshire shtojcat e metejsme te kesaj Marreveshjeje ne menyre qe kjo Marreveshje te kete efekt;

(c) Barredhenesi bie dakord dhe pranon qe ne rast mospermbushjeje barremarresi ka te drejte te kryerje ekzekutimine detyrueshem te barreve sigures ne perputhje me Ligj "Per barret sigures" dhe Barredhenesi nuk do te kerkoje procedure te ndryshme ekzekutimi nga ajo e parashikuar ne ligj duke hequr dore nga e drejta per ushtim te Nenit 32 te ketij ligji.

#### 4.2 SHPENZIMET

Barredhenesi duhet t'i paguaje Barremarresit, sipas kerkeses se gjitha kostot e arsyeshme te Barremarresit, taksat dhe shpenzimet duke perfshire, pa perjashtim, pagesat ligjore ne lidhje me pregatitjen, regjistrimin ose ndryshimin e kesaj Marreveshjeje, kompletimin apo ruajtjen e Barres Sigures, zbatimin ne cdo forme te dispozitave ose ushtimit e te drejtave, fuqive dhe mjeteve ligjore sipas Marreveshjes apo sipas Ligjit "Per barret sigures".

## Neni 5

### ARKETIMI I BORXHEVE

Perpara ose pas Mospermbushjes, Barremarresi mund t'i jape njoftim mbi Barren Sigures cdo personi qe eshte i detyruar te paguaje nje borxh apo detyrim qe perben Kolateral dhe mundet gjithashtu t'i drejtohet cdo personi per te bere te gjitha pagesat per llogari te nje borxhi te tille ndaj Barremarresit. Barredhenesi pranon qe cdo pagese e marre prej tij nga persona te tille ne rast Mospermbushjeje, qe eshte ne vazhdim, perpara apo pas njoftimit te ketij personi mbi Barren Sigures, do te merret dhe mbahet nga ai per Barremarresin dhe do t'i jepet Barremarresit sipas kerkeses se tij. Ne rast Mospermbushjeje, Barredhenesi bie dakord te depozitoje te gjitha te ardhurat qe rezultojne ne llogarin e tij ne favor te Barremarresit ne banken e aprovuar nga Barremarresi.

## Neni 6

### RASTET E MOSPERMBUSHJES

Rastet kur njera nga ngjarjet e meposhtme ndodh apo kushtet qe vijojne perbejne mospermbushje, qe ketej e tutje do t'u referohemi si "Rast i Mospermbushjes":

(a) deshtimi per te permbushur cdo lloj detyrimi, duke perfshire pa asnje kufizim mospagimin e principalit, interesave apo shuma te tjera qe perbejne pjese te Detyrimit te papaguar ne kohen e duhur sipas parashikimeve te Detyrimeve te Siguruara;

(b) keqinterpretimi thelbesor nga ana e Barredhenesit ne cdo marreveshje ose transakcion ndermjet Barredhenesit dhe Barremarresit;

(c) falimentimi ose mungesa e aftesisse paguese te Barredhenesit, njoftimi kunder Barredhenesit i procedurave te falimentimit;

(d) cdo proces gjyqesor qe behet i ekzekutueshem kunder Barredhenesit apo Kolateralit;

(e) nese nje pale tjetere qe ka pretendim mbi barren sigures kunder pasurise se Barredhenesit ben hapa per te ekzekutuar barre sigures te saj;

(f) nese Barredhenesi pushon apo paralajmeron se do te pushoje veprimtarine e vet tregtare, shet ose bie dakord te shese nje pjese te konsiderueshme te asetave te veta pa zbatuar ligjin perkates ose pa e njoftuar Barremarresin;

(g) nese, sipas Barremarresit, ne kushte te arsyeshme tregtare, Barra Sigures ose Kolaterali vihet ne rrezik.

#### 6.2 PERSHPEJTIMI

Ne rast Mospermbushjeje dhe ne cdo kohe me pas, Barremarresi nga ana e tij mund te deklaroje nje pjese ose te gjitha Detyrimet qe nuk konsiderohen te pagueshme me ane te kerkeses, te behen menjehere te tilla pa bere ndonje kerkese apo njoftim.

#### 6.3 MJETET LIGJORE NE RAST MOSPERMBUSHJEJE

Ne rast Mospermbushjeje, plus te drejtave dhe mjeteve ligjore te tjera qe mund te kete sipas ligjit, Barremarresi mund:


- Te zgjedhe te mbaje te gjithe apo nje pjese te kolateralit ne permbushje te detyrimeve te Barredhenesit sipas kesaj marreveshjeje ne menyren e parashikuar ne ligjin "Per Barret sigures"
- Te marre, te arketoje, te shese, te jape me qira, te marre para hua per te siguruara dorezimin e kolateralit tek palet e treta ose te veproje me kolateralin apo nje pjese te tij ne menyre te tille, sipas kushteve dhe termave te tilla, dhe ne kohen qe

lejohej nga ligji "Per barret siguruese"; si dhe mund te kerkoje ne emer te tij dhe t'u paguaje te tjereve shuma te arsyeshme per shpenzimet e marra persiper dhe per sherbimet e kryera ne lidhje me marrjen, arketimin, kryerjen, marrjen e huase per sigurimin, shitjen e kolateralit ose fitimin e pagesave nga ai dhe mund t'ia shtoje sasinë e ketyre shumave borxhit qe Barredhenesi ka ndaj Barremarresit.

- c) Te vazhdoje te ekzekutoje pagesat dhe te ushtroje te drejtat dhe mjetet ligjore te Barremarresit per te cilat parashikohet ne ligjin " Per barret siguruese" si dhe te gjitha te drejtat dhe mjetet ligjore ne dispozicion te barremarresit te cilat nuk bien ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar

## 6.4 MJETET LIGJORE JO-PERJASHTUESE

Te gjitha te drejtat, fuqite dhe mjetet ligjore te Barremarresit sipas kesaj marreveshjeje mund te ushtrohen ne vecanti ose te kombinuara dhe nuk zevendesojne, por jane shtese e cdo forme sigurimi ne vazhdim nga Barremarresi dhe te gjitha te drejtat e tjera, fuqite apo mjetet ligjore te Barremarresit, pavaresisht nga forma se si kane lindur apo jane krijuar.



## 6.5 PERGJEGJESIA PER MUNGESAT

Per sa kohe eshte ne perputhje me ligjin e zbatueshem, Barredhenesi mbetet pergjegjes per permbushjen e cdo Detyrimi qe nuk eshte permbushur plotesisht ose shlyer nga dhenia e te ardhurave qe lindin nga zbatimi i Barres Siguruese kundrejt Detyrimeve te Siguruara.

Neni 7

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### 7.1 VAZHDIMESIA E SIGURISE

Kjo Marreveshje dhe Barra Siguruese e krijuar sipas saj nuk zevendesojne por konsiderohen si shtese e barreve te tjera siguruese te mbajtura nga Barremarresi, dhe konsiderohet nje Marreveshje ne vazhdimesi dhe Barre Siguruese deri kur perfundon me shkrim dhe nenshkruhet nga palet.

### 7.2 KOMUNIKIMI

Kur cdonjeres nga palet i kerkohej apo i jepet e drejta te njoftoje, te drejtoje ose t'i beje nje kerkese pales tjetere, ky njoftim, drejtum apo kerkese duhet te jete me shkrim dhe quhet i mjaftueshem kur dergohet me poste te thjeshte tek kjo pale, ne adresat e fundit te raportuara nga pala.

### 7.3 PASARDHESIT DHE CESIONARET

Kjo Marreveshje duhet te jete e detyrueshme per Barredhenesin dhe pasardhesit e tij ose saj dhe duhet te siguroje qe eshte ne favor Barremarresit, pasardhesve te tij dhe cesionareve. Kjo Marreveshje duhet te jete e cedueshme (transferueshme) nga Barremarresi qe eshte i lire nga pretendimet ndermjet Barredhenesit dhe Barremarresit, dhe Barredhenesi nuk ka te drejte t'i kundërvihet cesionarit apo te ngreje ndaj tij pretendimet qe ai ka ndaj Barremarresit.

### 7.4 Pranimi i Shoqerise

Shoqeria pranon detyrimet e premtimeve te Barredhenesit sipas kesaj Marreveshjeje dhe bie dakort te mos ndermarre asnje veprim qe mund te cenoje ose ndaloje zbatimin e tyre .

Neni 8

## Verifikimi dhe raportimi i te dhenave

Palet ne kete kontrate bien dakord dhe deklarohet si me poshte :Duke kuptuar se, te dhënat tona demografike dhe financiare te ruajtura ne Regjistrin e Kredive te Bankës së Shqipërisë do te trajtohen ne perputhje me kuadrin ligjor dhe nenligjor ne fuqi per mbrojtjen e te dhenave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional si dhe per faktin se Banka Raiffeisen dhe Regjistri i Kredive te Bankes se Shqiperise kane marre te gjitha masat e nevojshem per te garantuar trajtimin e sigurt te te dhenave te mesiperme :

Autorizoj Raiffeisen Bank qe, per qellimet qe perfshijne:

- 1.vleresimin e aplikimit per te marre kredi;
2. vleresimin e rrezikut te kredise gjate gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën Raiffeisen dhe/ose
3. vleresimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit,

te njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrin të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/ aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka Raiffeisen, të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithë personat nenshkrues te kontrates , pra si per kredimarresit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per dorezanesit dhe apo hipotekuesit.

## 9. TE NDRYSHME

- 9.1 Kjo marreveshje do te zbatohet dhe do te interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 9.2 Barredhenesi autorizon Barremarresin te rregjistroje formularet e njoftimit te rregjistrimit dhe dokumenta te tjere dhe te ndermarre te gjitha veprimet qe Barremarresi mund te mendoje se jane te nevojshme per te kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Barres Siguruese, per te mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe per te ekzekutuar barren siguruese;
- 9.3 Kjo marreveshje eshte pjese e Kontrates se Huase ne Llogarine Rrjedhese dhe e detyrueshme si per palet nenshkruese, ashtu dhe per personat qe mund te zene vendin e tyre ose te cileve u jane transferuar te drejtat apo detyrimet.
- 9.4 Palet mund te ndryshojne vetem me shkrim elementet e kesaj marreveshjeje dhe t'i pasqyrojne ato ne Regjistrin e Barreve Siguruese.
- 9.5 Mosmarreveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.
- 9.6 Marreveshja nenshkruhet ne 7(shtate) kopje origjinale nese eshte rasti ne prani te perkthyesit, nga te cilat nje kopje per kredimarresin, nje per barredhenesin, dy per kredidhenesin, dy per Qendren Kombetare te Biznesit dhe nje kopje depozitohet prane noterit.

**KREDIDHENESI/BARREMARRES**  
**BANKA RAIFFEISEN**  
PERFAQESUAR NGA:

Erion BALLI

Gledisa BUXHUKU



**BARREDHENES**

Erion KOLA

Donalda KOLA

**KREDIMARRES:**  
Shoqeria "ESKO" shpk  
Perfaqesuar nga

Erion KOLA



NOTER